



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO



REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË

I.Numër: 400-01/29974/9, dt.29 Maj 2025.

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12 al. 2. pika d) të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28. datë: 04. Qershor 2008"), nenit 3 paragrafi 3.3. të Rregullores Nr. 02/2016 për tituj të nderit, dekorata, medalje, mirënjohje dhe falënderime dt. 01. Prill 2016, dhe nenit 13 paragrafi 1. pika 1.20, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I.Numër:01-016/01-413431 të dt: 30. Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 29 Maj 2025, në propozim të Komisionit të kuvendit dhe në rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, merr:

VENDIM

Nr. 50/2025

Për dhënien e titullit "Lekë Dukagjini"

Z. Gëzim Muriqi

1. **Z. Gëzim Muriqi**, nga Komuna e Pejës, i jepet titulli "**Lekë Dukagjini**", me motivacion:

"Për kontributin e tij të shquar dhe të jashtëzakonshëm si skulptori, autor i shumë veprave artistike në skulpturë, dy ndër tjera janë: shtatorja e Presidentit Ibrahim Rugova në Parkun e Paqes "Dr. Ibrahim Rugova" në Pejë dhe së fundi autor i shtatores së Skënderbeut tek Hora e Arbëreshëve në Itali, e cila reflekton dritën e historisë sonë dhe rezistencën e komunitetit ndër shokuj. Veprat e tij monumentale dhe krijimtarinë e pasur artistike, ka ngritur reputacionin e Pejës dhe të Kosovës në skenën kombëtare dhe ndërkombëtare. Skulpturat e tij përfaqësojnë jo vetëm talent të jashtëzakonshëm individual por edhe përkushtim për ruajtjen e kujtesës historike, figurave kombëtare dhe identitetit tonë kulturor".

2. Ky fakt do të evidentohet në regjistrin e veçantë të Qytetarëve të dekoruar nga Komuna e Pejës, të cilin e mban Kuvendi Komunal dhe kryetari i Komunës.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Pejës.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në Ueb faqen zyrtare të Komunës së Pejës.



KRYESUESI I KUVENDIT,
Z. Rexhep Kurtbogaj